



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 4184 Prot.

Pogradec, më 26.11.2025

VENDIM

NR. 122, DATË 25.11.2025

PËR

**MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM TË FONDIT
PYJOR/KULLOSOR, PËR QËLLIME NDËRTIMIN E PARKUT EOLIK
NË BASHKINË E POGRADECIT SUBJEKTIT "RENX ALBANIA" shpk .**

Në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, të pikave 5 dhe 6 të nenit 27 dhe shkronjës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjin Nr. 8480 datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjit Nr.7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", pikën 4 të nenit 12 të Ligjit Nr. 57/2020, "Për pyjet", Kreun VI të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin Nr. 43/2015 "Per sektorin e energjitikes", Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish komunave/ bashkive", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 822, datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", Ne referim te bazes ligjore te sipercituar, ky proces te kryhet sipas percaktimeve te Udhëzimi nr. 1, datë 09/06/2016, "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" dhe sipas tarifave të përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 559, datë 29.07.2022 " Per percaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhënie ne



shfrytezim/perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtarive ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore ", si dhe bazuar ne shkresa Nr. 7754 Prot, date 28/10/2021, e Ministrise se Infrastrukturës dhe Energjisë, me lëndë " Kërkesë për bashkëpunim mbi ankandin për energjinë e erës", si dhe shkresa Nr.2882/2 prot date, 22.10.2025 drejtuar Bashkisë Pogradec nga shoqëria Renx Albania shpk me lëndë "Kërkesë për dhënien e lejes për instalimin e shtyllës matëse për identifikimin e intesitetit të erës në teritorin në administrin të Bashkisë Pogradec, me synimin e ndërtimit të parqeve eolike", me propozim te Kryetarit te Bashkisë, Këshilli i Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë, dhënien në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor, në të cilat do të ngrihet parku eolik, për prodhim energjie nga era:

<i>Nr</i>	<i>X</i>	<i>Y</i>	<i>Bashkia</i>	<i>Zona Kadas</i>	<i>Nr. Pas</i>	<i>Ngastra</i> <i>t</i> <i>Pyjore</i> <i>/Kullos</i> <i>ore</i>	<i>Përdorimi</i>
Q_0 8	466034. 94	4540304. 40	Pograd ec	3665	460	5c	Pyll cungishte
Q_0 9	465779. 32	4538905. 06	Pograd ec	3665	811	12K	Kullotë
Q_1 0	465408. 83	4537888. 91	Pograd ec	1959	486	12K	Kullotë
Q_1 3	465896. 63	4535563. 75	Pograd ec	1959	456	11K	Kullotë
Q_1 4	466387. 59	4534947. 66	Pograd ec	1959	822	10a	Pyll cungishte
Q_1 5	466638. 23	4534387. 33	Pograd ec	1959	822	10a	Pyll cungishte

Gjithsej 6 Turbina nga 7500 m2 sejcila siperfaqja totale 45000 m2 ose 4.5 Ha, pjesa e rrugeve te aksesit, linjat e tensionit si dhe pjesa e nenstacionit elektrik.

2. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, në respektim të pikes 23 të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor /kullosor publik", subjekti "Renx Albania" shpk duhet të paraqesë



dokumentacionin teknik-ligjor të kërkuar pranë strukturës përgjegjëse për pyjet në bashki, e cila ka të drejtën për hartimin e studimit teknik-ekonomik të sipërfaqes objekt përdorimi.

3. Tarifat për dhënien në përdorim/qera të ketyre pasurive, të aplikohen sipas pikes "8", te shtojces nr 1 të Vendimit Nr. 559, datë 29.07.2022 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhenien ne Shfrytezim/ perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.

4. Afati i dhenies me qera te jete deri ne 10 vite, me te drejte ripertëritje.

5. Autorizohet Kryetari i Bashkisë Pogradec, të nënshkruajë kontratën e qerasë, pasi të jetë hartuar raporti tekniko –ekonomik.

6. Ngarkohet Agjensia e Mbrojtjes Teritorit, Sektori i Sherbimi Pyjor, Sektori i Verifikimit titujve pronesise për zbatimin e këtij vendimi.

7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”.

8. U shpall sot më datë __. __. 2025.

KRYETARE E KËSHILLI

Manjola KAMOLLI

1. Miratuar me 19 vota

2. Vota Pro 19

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 3

5. Zbardhur më date 25.11.2025

